



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 19 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, nenit 36 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtar Publik, nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Rregullores Nr. 03/2022 për Praktikantë në Sistemin Prokurorial lidhur me procedurën për rekrutim të praktikantëve vullnetarë pa pagesë, për periudhën një (1) vjeçare në sistemin prokurorial të Kosovës, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpallë këtë:

K O N K U R S
Nr. 03/2025

Për praktikantë vullnetar pa pagesë, për periudhën një (1) vjeçare, si në vijim:

NR.	NJËSIA	NUMRI I PRAKTIKANTËVE	KUALIFIKIMI
1.	Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë	3	Diplomë Universitare Fakulteti Juridik
2.	Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë	1	Diplomë Universitare Fakulteti Ekonomik
	GJITHSEJ:	4	

Detyrat kryesore të praktikantit/es:

- Ndhmon stafin e sistemin prokurorial në kryerjen e detyrave si dhe kryen punë të tjera në koordinim me zyrtarët e Njësitet për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.
- I Përmbahet rregullave të brendshme të sjelljes, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në vijueshmëri, orarin e punës, kodin e veshjes dhe konfidentalitetin.
- Në përputhje me legjislacionin në fuqi duhet të gëzojnë të drejtën për pushim ditor, pushimin vjetor, festat zyrtare dhe mbrojtjen nga orët e tepërta të punës.
- Praktikanti duhet të ketë mundësinë që të aftësohet në aspektin profesional në kuadër të detyrave dhe përgjithësive të cilat i janë ngarkuar.
- Përgatitjen e raportit gjashtë mujor dhe në fund të praktikës, ose sipas kërkesë së mbikëqyrësit me angazhimet e kryera.
- Kryen edhe detyra tjera të caktuara nga zyrtarët e sistemit.
- Përfshihet praktikantët të cilët janë të fushave tjera, siç janë praktikant në financa, teknologji informative, administratë, burime njerëzore si dhe shërbime të tjera të përgjithshme detyrat përcaktohen nga udhëheqësit e njësive përkatëse brenda Prokurorit të Shtetit dhe në Sekretariatit e KPK-së sipas nevojës.

- Për punën e tyre praktikantët në Njësitin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë mbikëqyren nga udhëheqësit e njesisë, ndërsa në prokurori nga administratori i prokurorisë.

Kualifikimi:

- Diplomë Universitare - Fakulteti Juridik;
- Diplomë Universitare - Fakultetit Ekonomik.

Aftësitë dhe Shkathtësitë e kërkuara:

- Njohuri të procedurave administrative, etj.;
- Aftësi për përgatitjen e akteve juridike;
- Aftësi të punës me kompjuter;
- Shkathtësi komunikimi.

Dokumentet për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit;
- Diploma apo certifikatë universitare;
- Certifikata e gjendjes penale.

VËREJTJE:

- Konkursi është i hapur (15) ditë nga dita e shpalljes së lajmërimit më datën: **22.04.2025** dhe mbyllet me datë **06.05.2025**.
- Kandidatët praktikantë duhet të plotësojnë formularin standard për aplikim që është dispozicion në ueb faqen e KPK-së: www.prokuroria-rks.org.

Forma e aplikimit:

- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00 në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës/Departamenti i Burimeve Njerëzore kati IV, Rr. "Luan Haradinaj", Objekti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, 10000 Prishtinë
- Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Departamentin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj" objekti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.
- Aplikacionet pas skadimit të afatit të konkursit të lartë cekur nuk pranohen.